



Për ju që vaksinoheni kundër Covid-19

Ju që keni marë ofertën për vaksinim kundër Covid-19 mbase keni pyetje përpara se të merrni vendimin tuaj. Ky informacion mund t'ju ndihmojë para, gjatë dhe pas vaksinimi.

Sëmundja covid-19 shkaktohet nga një virus. Shumica e atyre që sëmuren me covid-19 kanë shqetësime të lehta, por një pjesë sëmuren seriozisht. Në rastet më të këqija, nga kjo sëmundje mund të vijë deri tek vdekja.

Vaksinimi ju mbron dhe të tjerët

Vaksinimi kundër covid-19 mund t'ju mbrojtë që ju mos t'a merrni sëmundjen, dhe kjo madje edhe redukton rrezikun që ju të infektoni të tjerë. Në periudhën afatgjatë kjo e kufizon përhapjen e infeksionit.

Kujt i ofrohet vaksinimi?

Aktualisht, sipas rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, vaksinimi kundër covid-19 j'u ofrohet personave nga moshë 18 vjet e sipër. Megjithatë, vakcina në radhë të parë iu ofrohet atyre të cilët kanë sëmundje të seriozisht.

Mund të nevojitet një vlerësim individual

Për fillim, vaksinimi nuk iu ofrohet personave nën 17 vjeç ose grave shtatëzëna. Megjithatë, me rritjen graduale të njohurive rreth sëmundjes, situata mund të ndryshojë. Varësisht nga vakcina dhe problematika themelore e individit në raste të veçanta.

Rreziku i sëmurjes rëndë rritet me moshën

Rreziku që ju të sëmureni rëndë me covid-19 rritet me moshën, sidomos nëse jeni 70 vjeç ose më i moshuar. Përveç kësaj, personave me disa sëmundje të caktuara iu kanoset një rrezik më i shtuar në krahasim me të tjerët që të goditen nga një covid-19 serioz, pa dallim nga moshë.

Krijon një mbrojtje nga sëmundja serioze

Pas vaksinimit, imuniteti i trupit krijon një mbrojtje kundër covid-19, ndonëse nuk është e sigurt që të gjithë të vaksinuarit marrin mbrojtjen e plotë. Kjo vlen për të gjitha vaksinat dhe jo vetëm për këtë kundër covid-19.

Para vaksinimit

Vaksinimi ndaj covid-19 është vullnetar.

Ju të cilët dëshironi të dini më shumë rreth vendimit mbi vaksinimin gjeni fakte dhe informata në 1177, te Institutit Kombëtar i Shëndetësisë dhe te Institutit Farmaceutik. Shih të dhënat kontaktuese në faqen tjetër.

Kështu zhvillohet vaksinimi

Para vaksinimit, ju do të plotësoni një deklaratë shëndetësore.

Një infermiere do t'ju japë vaksinën me anë të një injeksioni në krah. Nëse ka nevojë të vaksinoheni dy herë, ju do të merni vaksinën e llojit të njëjtë të dyja herët.

Pas injektimit, ndodh që vendi dhemb nëse preket, skuqet, ënjtet ose ndjehet kuarje në tërë krahun. Një pjesë e njerëzve mund të përjetojnë temperaturë të përkohshme, kokëdhimbje ose një ndjenjë të përgjithshëm sëmundjeje. Të tëra këto janë reaksione normale të imunitetit tonë trupor. Simtomet janë zakonisht të buta dhe kalojnë pas ndonjë dite. Reaksionet alergjike janë tepër të rralla.

Pas vaksinimit

Nëse ndiheni keq ose jeni me merak pas vaksinimit, kontaktoni sistemin shëndetësor në mënyrë që simtomet tuaja të shqyrtohen, pa dallim se nëse ato lidhen me vaksinimin ose jo.

Sistemi shëndetësor ka për detyrë që të raportojë efekte të dyshuara anësore te Institutit Farmaceutik. Nëse ju, pas vaksinimit përjetoni efekte anësore, raportimin mund t'a bëni edhe vetë në www.lakemedelsverket.se/rapportera.

Sidoqoftë, ju kanoseni më pak nga rreziku që të sëmureni seriozisht.

Merr një javë pas dozës së fundit deri sa të krijohet mbrojtja

Varësisht se cila vaksinë është përdorur, do të nevojiten një numër i ndryshëm i dozave për të krijuar një mbrojtje të mirë. Aktualisht nevojiten dy doza. Mund të zgjat për afërsisht deri në një javë pas dozës së fundit, para se organizmi të ketë krijuar një mbrojtje të plotë.

Për ju të cilët jeni duke mbështetur vendimin e një të afërmit tuaj rreth vaksinimit

Ju të cilët mbështetni një të afërm në vendimin e të vaksinuarit ndodh që mund të keni nevojë të flisni me një mjek ose infermiere, në rast se keni pyetje. Kjo veçanërisht nëse i afërmi i juaj ka një prirje ose afinitet për hemorragji, nëse ai/ajo ka ndonjë patologji anësore ose nëse merr ilaçe të cilat ndikojnë në imunitet.

Më shumë për sëmundjen covid-19

Simtomet nga covid-19 janë të ndryshme. Më së shpeshti ato ngjasojnë me ato të një ftohjeje të rëndë ose të një infeksioni nga gripi. Temperatura dhe kollitja janë simtomet më të rëndomta, ndonëse ndodh që i kapluari të ketë një ose disa nga këto simtome: vështirësi me frymëmarrjen, rrufë, zënie e hundës, dhimbje fyti, kokëdhimbje, përzierje, barkqitje, puçrra në lëkurë, humbje ose reduktim i shqisës së shijes, dhimbje muskulare dhe e nyjeve.

Regjistri kombëtar i vaksinimit

Të gjitha vaksinimet kundër covid-19 do të regjistrohen në regjistrin kombëtar të vaksinimeve. Informacioni i cili do të regjistrohet është numri personal ose numri koordinues, data e vaksinimit, lloji i vaksinës së përdorur, numri i brumit, aktori dhënës i vaksinës, numri i dosiesë së vaksinës ndaj covid-19.

Kjo bëhet në mënyrë që të jetë i mundur përcjellja e vaksinimeve. Të dhënat janë të mbrojtura nga konfidencialiteti absolut dhe nuk janë të disponueshme nëpërmjet regjistrit të sistemit shëndetësor mbi pacientin. Ju keni të drejtë të kërkonit kopjen e të dhënave sipas Udhëzimit Administrativ për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR).

Informacion rreth produktit – vaksinës

Informacionin aktual rreth vaksinës së marë e gjeni në formë digjitale në faqen e internetit të Institutit Farmaceutik. Ju mund të printoni informacionin ose mund t'a lexoni atë direkt te ueb-faqja.

Për më shumë informacion dhe të dhëna kontaktuese

Informacione të tjera që vlejné për ju, aty ku banoni:

- 1177 Vårdguiden – [1177.se](https://www.1177.se)

Rekomandimet mbi vaksinimin dhe për parandalimin e infeksionit:

- Institutit Kombëtar i Shëndetësisë – [folkhalsomyndigheten.se](https://www.folkhalsomyndigheten.se)

Vazhdo të mbrosh veten dhe të tjerët

Ju që e keni marë vaksinën duhet edhe më tej të ndiqni rekomandimet për të parandaluar përhapjen e infeksionit.

Ndiqni zhvillimet dhe vazhdoni të:

- rri në shtëpi nëse jeni të sëmurë
- mbani distancën ndaj të tjerëve
- lani duart shpesh.

Vaksina kundër covid-19:

- Institutit Farmaceutik – lakemedelsverket.se/coronavaccin
- Qendra informative farmaceutike, tel: 0771-46 70 10

Përgjigje rreth pyetjeve të përgjithshme mbi covid-19 për qytetarët:

- [krisinformation.se](https://www.krisinformation.se)
- 113 13 – qendra informative kombëtare